



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKISË GRAMSH

Nr 2341 / 12 prot

Gramsh, më 05/02/2021

**V E N D I M**

Nr. 02 datë, 29 01/2021

**P Ë R**

**NDRYSHIMIN E DESTINACIONIT TË PRONËS NR.334 ME EMËRTIM ‘‘ISH -REPART USHTARAK 9920 ,’’ GRUP DEPO ‘‘ ME VENDODHJE ‘‘PËRROI I ÇEKREZIT ‘‘ GRAMSH, NGA NDERTIM PER IMPIANTIT TE PERPUNIMIT TE BETJEVE URBANE TE SHËRBEJE PËR NDERTIMIN E VARREZAVE TË REJA TË QYTETIT NË TERITORIN E BASHKISË GRAMSH**

Këshilli i Bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të datës 29 / 01 / 2021 , pasi mori në shqyrtim Relacionin dhe P/Vendimin nga Kryetari i Bashkisë dhe Sektori i Menaxhimit të Aseteve ,në zbatim të ligjit nr,8744, date 22.02.2001 ‘‘Për transferimin e pronave të palujtshme publike të shtetit në njësit e qeverisjes vendore ‘‘ i ndryshuar, si dhe në zbatim të VKM nr, 500, datë 14.08.2001 ‘‘Për inventarizimin e pronave të Palujtshme Shteterore dhe transferimin e pronave në njësit e qeverisjes vendore ‘‘ pika 14 .Në zbatim të ligjit Nr.20/2020 ‘‘Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqiperisë ‘‘ Kreu IV si dhe në mbeshtetje të ligjit Nr.139 datë , 17.12.2015 ‘‘ Për Vetëqeverisjen Vendore’’ neni 8 , pika 2,neni 9,pika 1,2/a.me propozimin e kryetarit të Bashkisë Keshilli i Bashkisë .

**V E N D O S I**

- I.** Të miratojë ndyshimin e destinacionit të pronës nr.334 me emërtim ‘‘Ish-Reparti Ushtarak nr.9920 Grup Depo’’,me vendndodhje ‘‘Përroi i Çekrezit’’,Gramsh, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr,58 ,datë 27.1.2016 .
- II.** Destinacioni i ri i pronës të shërbejë për ndërtimin e varrezave të reja të qytetit në territorin e Bashkisë Gramsh .
- III.** Paraqitja e materialit për miratimin në Këshillin e Ministrave .

IV. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise dhe Sektori i Menaxhimit të Aseteve Vendore .

Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes !

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Greta LENA**



**Konceptoi: Xhulia Gjini**  
**Miratoi: Greta Lena**